


VENDIM QARKULLUES
Nr. 4, datë 05.11.2019
PËR
**“MIRATIMIN E PROGRAMEVE TË AGJENCISË KOMBËTARE TË DIASPORËS
PËR PERIUdhËN NËNTOR-DHJETOR 2019”**

Në mbështetje të nenit 8 të Ligjit Nr. 115/2017 “Për Krijimin e Agjencisë Kombëtare të Diasporës”, të vendimit Nr. 114/2018 të Këshillit të Ministrave “Për emërimin, shkarkimin dhe shpërblimin e anëtarëve të Këshillit Drejtues të Agjencisë Kombëtare të Diasporës”, Këshilli Drejtues,

VENDOSI:

1. Miratimin e programeve të rishikuara të Agjencisë Kombëtare të Diasporës për periudhën Nëntor-Dhjetor 2019, me vlerë 31,548,507 (tridhjetë e një milion e pesëqind e dyzet e tetë mijë e pesëqind e shtatë) lekë, bashkëlidhur këtij vendimi.
Rialokimi është për vlera brenda buxhetit vjetor, kursyer nga aktivitetet e parashikuara më parë brenda planit të aktiviteteve vjetore të Agjencisë, duke mundësuar zhvillimin e aktiviteteve shtesë, brenda buxhetit të Agjencisë, sipas prioriteteve.
Kjo vlerë është pjesë e mbetur e shumës prej 57,841,331 (pesëdhjetë e shtatë milion e tetëqind e dyzet e një mijë e treqind e tridhjetë e një) lekë, pas realizimit të aktiviteteve të miratuara me Vendimin Nr. 3, datë 26.08.2019 të Këshillit Drejtues të Agjencisë Kombëtare të Diasporës.

Ky vendim hyri në fuqi menjëherë,

KËSHILLI DREJTUES

Etjen	XHAFAJ	KRYETAR
Rovena	VODA	ANËTARE
Anila	FERIZAJ	ANËTARE
Ornela	ÇUÇI	ANËTARE
Elona	BANO	ANËTARE
Suzana	STEFA	ANËTARE
Kozeta	ANGJELIU	ANËTARE